

VENDIM
Nr. 495, datë 1.8.2012

**PËR DHËNIE TË ÇMIMEVE DHE SHPËRBLIMEVE SHKENCORE PERSONAVE QË KANË
PUNUAR PËR KRIJIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE ELEKTRONIKE NË
FUSHËN E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimin publik të z. Aristotel Agaraj për krijimin e sistemit elektronik “One-Stop Shop-Sistemi i Noterisë” dhe për kalimin në pronësi, pa kundërshtpërblim, të këtij sistemi Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim vënien në përdorim në shërbim të publikut.

2. Vlerësimin publik të z. Xhevair Llakaj për krijimin e portalit elektronik të kërkesave për shërbime pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe vënien e këtij sistemi në shërbim të publikut.

3. Vlerësimin publik të z. Agim Kasaj për ndërtimin e portalit elektronik të gjykatave dhe për përmirësimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

4. Ministri i Drejtësisë t’i akordojë z. Aristotel Agaraj çmimin “Mirënjohje publike”, nëpërmjet një ceremonie publike që do të zhvillohet në Ministrinë e Drejtësisë.

5. Z. Aristotel Agaraj t’i jepet një shpërblim në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

6. Z. Xhevair Llakaj t’i jepet një shpërblim në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

7. Z. Agim Kasaj t’i jepet një shpërblim në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

8. Çmimi dhe shpërblimet shkencore të jepen brenda një muaji nga miratimi i këtij vendimi.

9. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Masa e shpërblimit, e përcaktuar në pikën 5, të përballohet nga shpenzimet korente të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Masa e shpërblimit, e përcaktuar në pikat 6 dhe 7 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë i planifikuar në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

10. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha